



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P-144
Prishtinë, më 21 nëntor 2013

PROCESVERBAL

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 21 NËNTOR 2013**

Mbledhjen e kryesoi kryetari Jakup KRASNIQI, ndërsa i ndihmoi nënkryetari Xhavit HALITI.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Në fillim të seancës, me propozim të kryetarit, Kuvendi e mbajti një minutë heshtje në shenjë nderimi për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Sokol Olldashi, i cili e kishte humbur jetën në aksident trafiku.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Sabri Hamiti, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Duda Balje, Goran Marinković, Adem Grabovci, Teuta Sahatqija, Rexhep Selimi, Xhevdet Neziraj, Sasha Gjokiq, Ganimete Musliu, Rita Hajzeraj-Beqaj dhe Xhavit Haliti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Ministri Ferid Agani po ashtu diskutoi lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Diskutimet e ministrit janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Bekim Haxhiu parashtrroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me shkeljen e Ligjit për lojërat e fatit nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila subjekteve ekonomike u lëshon licenca për hapjen e lokaleve në afërsi të objekteve edukative-arsimore.

Ministri Besim Beqaj iu përgjigj pyetjes së deputetit Bekim Haxhiu.

Deputetja Aurora Bakalli parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me zbatimin e Ligjit për kontrollin e duhanit.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputeti Liburn Aliu parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me hapat që ka ndërmarrë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për rritjen e numrit të inspektorëve në Inspektoratin e Punës.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Liburn Aliu.

Deputetja Nazane Breca parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me kohën kur do të sillet në Kuvend Projektligji për sigurimet shëndetësore.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Nazane Breca parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me kohën kur do të sillet në Kuvend Projektligji për sigurimet shëndetësore.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Nazane Breca.

Deputetja Time Kadrijaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani në lidhje me atë se a do të vazhdojë përkrahja e Ministrisë së Shëndetësisë ndaj Emergjencës Pediatrike, e cila vepron në kuadër të njësisë së Klinikës së Pediatrisë.

Ministri Ferid Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Time Kadrijaj.

Deputeti Visar Ymeri parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me atë se a janë vizituar punëtorët e kompanisë “Bechtel-Enka” nga inspektorët e Inspektoratit të Punës.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Visar Ymeri.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,
5. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Fshatin Zym i Hasit
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave.

* * *

3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 14 dhe 15 nëntor 2013.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët me kërkesën e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re për zëvendësimin e anëtares të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Ai hodhi në votim formal kërkesën e lartpërmendur.
Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Deputetja Myzejene Selmani emërohet anëtare e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në vend të deputetes Suzan Novobërdaliu.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, sqaroi para deputetëve procedurat që ka ndjekur Radiotelevizioni i Kosovës lidhur me kërkesën për transferimin e mjeteve monetare në shumë prej një milion euro dhe arsyet pse Kuvendi nuk ka marrë vendim për një transferim të tillë.

Më tej, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Ministri i Financave, Besim Beqaj, theksoi se ky projektligj është hartuar në pajtim të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore.

Përgatitja e këtij projekt-buxheti ka efekte afatgjate dhe është i integruar në kornizën afatmesme ekonomike dhe fiskale të Qeverisë, nëpërmjet së cilit parashihet që në vitin 2013 norma e rritjes ekonomike të jetë ndër më të lartat në rajon, në vitin 2014 të jetë 4,9%, ndërsa mesatarja për 3 vjetët e ardhshme 4,6%, duke u bazuar në projeksionet për rritje të investimeve, eksportit dhe konsumit.

Gjatë vitit 2014 do të shënohet ngritje në: investimet private 10%, eksporti i përgjithshëm 7%, eksporti i mallrave 10%, konsumi agregat 6,2%, konsumi privat 6,2%, të hyrat e përgjithshme buxhetore 2,5%, të hyrat nga tatimet e brendshme dhe ato doganore 7%, të hyrat e brendshme 22%, të hyrat jotatimore 8,5%, të hyrat vetjake të komunave 6,7%, kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 12%, kategorinë e subvencioneve dhe transfereve 5,7%, çmimet e importit 1,5 %, buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 4 milionë €, buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë 7,5 milionë €, përfshirë huan prej 25 milionë dollarëve nga Banka Botërore, buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 5 milionë €, buxhetin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale 23 milionë €, buxhetin e Ministrisë së Diasporës - 2,2 milionë €, si dhe ngritje në shpenzimet e përgjithshme, buxhetin për paga dhe mëdijtje, ndërsa rënie të të hyrave vetjake të nivelit qendror 31%.

Ai më pas u fokusua në strukturën dhe përmbajtjen e projektligjit dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa e paraqiti kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Më tej, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Në lidhje me debatin për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, deputeti Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së,

propozoi që për shkak të racionalizimit të kohës, diskutimet në emër të grupeve parlamentare të zgjasin 10 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve 7 minuta.

Për propozimin e lartpërmendur diskutuan: Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”; Daut Haradinaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së; Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re; Sasha Milosavljeviq, në emër të Grupit Parlamentar SLS; Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas diskutimeve, deputeti Bekim Haxhiu e tërhoqi mocionin e lartpërmendur.

Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, theksoi se nga projektbuxheti i planifikuar për vitin 2014, Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon me realizimin e projekteve madhore në interes të vendit, në ndërtimin e autostradave, rrugëve rajonale dhe lokale, investimet në infrastrukturën arsimore dhe sportive, mbështetjen e sektorit të bujqësisë, mbështetjen e reformave në sektorin e shëndetësisë, si dhe investimet në të gjithë sektorët e tjerë, që drejtpërdrejt ndikojnë në përmirësimin e kushteve për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në fund ajo e përkrahu Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014 dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, theksoi se ky projektbuxhet është buxhet shpenzues, pa perspektivë dhe që nuk e rrit mirëqenien e qytetarëve dhe sjell depresion në ekonomi, si dhe rritje të normës së papunësisë.

Në fund ai u shpreh se grupi parlamentar që ai përfaqëson nuk e përkrah këtë projektbuxhet, pasi, përveç të tjerash, nuk është bërë shpërndarje proporcionale e investimeve kapitale dhe nuk janë përfillur rregullat e caktimit të prioritetëve për shpërndarjen e këtij buxheti.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, theksoi se edhe ky projektbuxhet është përpiluar në formën e njëjtë sikur buxheti paraprak dhe e zëvendëson deficitin buxhetor me rritje të borxhit publik, si dhe pamundëson zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Në fund ai deklaroi se grupi parlamentar të cilin ai e përfaqëson do të votojë kundër Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, theksoi se për shkak të gabimeve teknike, mospërputhjes së shifrave dhe caktimit të gabuar të prioritetëve, të cilat parashihen të realizohen me këtë projektbuxhet, grupi parlamentar të cilin ai e përfaqëson nuk e përkrah Projektbuxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, theksoi se megjithëse ky projektbuxhet nuk i përmbush kërkesat e qytetarëve të Kosovës, grupi parlamentar të cilin ajo e përfaqëson e përkrah këtë projektbuxhet.

Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar SLS, theksoi se buxheti i paraparë për vitin 2014 është i pamjaftueshëm për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale të qytetarëve të

Kosovës. Mirëpo, projektbuxheti ka veti pozitive, ngase është përpiluar në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe rritjen në të hyrat doganore.

Në fund, në emër të grupit parlamentar të cilin ajo e përfaqëson deklaroi se e përkrah këtë projektligj.

Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, theksoi se me këtë projektbuxhet shënohet ngritje ekonomike, në krahasim me vitin e kaluar.

Në fund, në emër të grupit parlamentar që ajo përfaqëson, e përkrah Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2014.

Goran Marinković, në emër të Grupit Parlamentar ZB, tha se e përkrah Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2014, me disa vërejtje, të cilat do t’ia paraqesë Komisionit Funkcional.

Diskutimet e plota të kryetarëve (përfaqësuesve) të grupeve parlamentare janë dhënë të plota në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ramiz Lladrovci, Hykmete Bajrami, Albulena Haxhiu, Xhevdet Neziraj, Fikrim Damka, Behar Selimi, Afërdita Berisha-Shaqiri, Glauk Konjufca, Time Kadrijaj, Valbona Dibra, Haki Demolli, Rexhep Selimi, Donika Kadaj-Bujupi, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Albin Kurti, Jakup Krasniqi, Vjosa Osmani, Bekim Haxhiu, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Nijazi Idrizi, Jeton Svirca, Emilija Rexhepi, Hydajet Hyseni, Afrim Hoti, Sala Berisha-Shala, Vjollca Krasniqi, Albana Fetoshi, Blerta Deliu-Kodra, Muhamet Mustafa, Liburn Aliu, Nazane Breca, Lirije Kajtazi, Ali Sadriu, Hamza Balje, Bahri Thaçi, ministrat: Fehmi Mujota dhe Besim Beqaj, si dhe kryeministri Hashim Thaqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, siç vijon:

Për ----- 59,
Kundër ----- 31,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa si Komision Funkcional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014

Kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa për arsyetimin e rekomandimit të këtij komisioni për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014.

Më tej, kryetari e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2014.

Rezultati i votimit ishte, siç vijon:

Për ----- 68,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës investive prej 0,40% dhe taksën operacionale prej 0,13% për periudhën 1 janar-30 dhjetor 2014.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fshatin Zym i Hasit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funksional raportues për Projektligjin për Fshatin Zym i Hasit

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Nait Hasani, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Për këtë pikë të rendit të ditës, deputeti Sabri Hamiti propozoi që amendamenti 1, në nenin 1të Projektligjit të riformulohet, si në vijim: *“Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore e fshatit Zym i Hasit dhe promovimi i tij si fshat me vlera kulturore të rëndësishme lokale, shtetërore e ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm dhe harmonizimi i tij”*.

Deputeti Nait Hasani propozoi që fillimisht të hidhet në votim amendamenti i propozuar nga Komisioni Funksional, e më pas varianti i propozuar nga deputeti Sabri Hamiti.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi imiratoi këto amendamente: 1 (të propozuar nga nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti), 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, siç vijon:

Për ----- 65,
Kundër ----- 9,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash Ligjin për fshatin Zym i Hasit.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sistemin e lejeve dhe licencave

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për sistemin e lejeve dhe licencave.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Zenun Pajaziti, diskutimi i plotë i të cilit është dhënë në transkript.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, siç vijon:

Për ----- 53,
Kundër ----- 21,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash Ligjin për sistemin e lejeve dhe licencave.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 19:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

E përgatiti:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale